



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 491 Prot.
01

Tiranë, më 14.05.2019

Lënda: **Sqarim mbi pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Berat**

BASHKISË BERAT

Adresa: Bulevardi "Republika", Berat

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit**, është autoriteti përgjegjës i ngarkuar me ligj për bashkërendimin e procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror e vendor.

Nëpërmjet shkresës Nr. 1093/2 Prot, datë 06.05.2019, protokolluar pranë AKPT me Nr. 491 Prot, datë 08.05.2019 me lëndë "Dërgim dokumentacioni për marrjen e Aktit të Përputhshmërisë", Bashkia Berat, ka kërkuar pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë së dokumentit të rishikuar të PPV-së.

Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, ka kryer kontrollin e tij, duke konstatuar se Bashkia Berat nuk ka kryer botimin në RKPT të materialit për të cilin kërkohet pajisja me Aktin e Përputhshmërisë.

Gjithashtu, AKPT ka vlerësuar se materiali i dërguar nga bashkia Berat me shkresën e sipërcituar nuk është në përputhje me formatin e rishikimit të PPV të dërguar nga AKPT në adresë të bashkisë Berat me e-mailin e datës 25 prill.

Për sa më sipër, në zbatim të **VKM Nr. 686, datë 22.11.2017**, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", në nenet 11 dhe 12 të saj, dhe **Udhëzimit Nr. 01, date 22.02.2019**, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT, "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe këshillimin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar" (dërguar me e-maillet e datave 1 mars dhe 25 prill), për pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Berat, është e nevojshme të realizoni pikat e mëposhtme:

- Përgatitjen e materialit të plotë për rishikimin e PPV-së:
 - Dokumenti i rishikimit të PPV-së, sipas Formatit përkatës;
 - Materiali GIS ku reflektohen ndryshimet e propozuara;

- Botimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

Ritheksojmë se, botimi i plotë në RKPT i dokumentacionit të mësipër, është kusht i domosdoshëm për nisjen e vlerësimit të përputhshmërisë së tij nga AKPT dhe lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë.

Në përfundim, mbetemi në dispozicion për vijimin e konsultimit të ndryshimeve në kuadër të rishikimit të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Berat.

Me respekt,

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Adelina Greca

Konceptoi/ Punoi: *F. Mali*
Nr. Kopje: 2
Datë: 14.05.2019